

Ekspert Mjedisi

Mundësi për punë me orar të plotë ose praktikë pune

Instituti i Kërkimeve Urbane është një organizatë jofitimprurëse e krijuar me Vendim të Gjykatës së Tiranës më 28 maj 1999. Selia e URI-së ndodhet në Tiranë.

Misioni

Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) heton problemet sociale dhe ekonomike me të cilat përballet vendi, së bashku me politikat e qeverisë qendrore dhe vendore të hartuara për zgjidhjen e tyre. Misioni i IKU-t në këtë sipërmarrje është ndërgjegjësimi i shoqërisë dhe mprehja e të menduarit kritik për këto probleme dhe ndikimin e politikave qeveritare, me qëllim përfundimtar përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe zbatimit në nivel qendror dhe vendor.

Stafi dhe grafiku organizativ

Instituti i Kërkimeve Urbane punëson staf të përhershëm i cili përfshin ekspertiza të ndryshme që i përgjigjen fushës së shërbimeve të tij. Struktura e tij organizative përbëhet nga tre departamente kryesore duke përfshirë:

- (i) Planifikimi dhe Zhvillimi;
- (ii) Hulumtimi dhe
- (iii) Financa dhe Administrata;

Në të njëjtën kohë, IKU bashkëpunon me një spektër të gjerë ekspertësh të jashtëm sipas kërkesave të projekteve specifike.

IKU ka një zyrë të vendosur në qendër të qytetit të Tiranës. Zyra ofron të gjitha shërbimet dhe pajisjet e nevojshme për një funksionim të lehtë.

Fusha e veprimit

IKU ka punuar gjatë 22 viteve të fundit në fusha të ndryshme ku nevojitej asistencë teknike si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal, duke përfshirë politikëbërjen, kërkimin dhe ndërtimin e kapaciteteve, menaxhimin e projekteve dhe planifikimin e investimeve. IKU ka fituar përvojë të gjerë në ofrimin e një sërë klientëve publikë dhe privatë me një sërë mbështetjesh, asistence dhe shërbimesh, duke u fokusuar në monitorimin e bazuar në performancë, duke përfshirë konceptimin dhe zbatimin e monitorimit të bazuar në performancë në disa bashki dhe institucione në Shqipëri.

IKU ka marrëdhënie të ngushta pune me institucione në nivel qendror dhe vendor duke përfshirë disa ministri, si dhe me shumicën e 61 njësive të qeverisjes vendore në vend. Krahas shoqërisë civile dhe agjencive qeveritare, IKU ka zhvilluar marrëdhënie të ngushta me disa organizata donatore që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj, ndër të cilat më kryesoret: Banka Botërore, UNDP, BERZH, Sëiss Cooperation Development, Helvetas Sëiss Intercooperation, GIZ, Ambasada Hollandeze, Komisioni Evropian, SIDA, Soros, dhe USAID, Ambasada e SHBA, etj.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të punonjësit/es

Kërkim dhe analizë: Kryerja e kërkimeve mbi çështjet mjedisore, politikat dhe praktikat më të mira, si dhe analizimi i të dhënave për të mbështetur përpjekjet e avokimit të bazuara në prova.

Advokimi: Ndhma në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave advokuese që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore, ndikimin në politikbërje dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme;

Menaxhimin e projekteve: Suport në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve dhe nismave mjedisore, duke përfshirë koordinimin me grupet e interesit dhe sigurimin e përmbushjes së objektivave të projektit;

Analizimi i politikave/legjislacionit: Kontribut në analizën e politikave/ligjeve dhe rregulloreve mjedisore, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e politikave dhe rregulloreve;

Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi: Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me Organizata të Shoqërisë Civile, komunitetet, institucione publike, institucionet akademike dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë në çështjet mjedisore;

Komunikimi: Suport në zhvillimin e materialeve të komunikimit, të tilla si raporte, artikuj dhe publikime në mediat sociale, më qëllim për të komunikuar në mënyrë efektive mesazhet mjedisore dhe për t'u angazhuar me grupet e interesit;

Monitorimi i Biodiversitetit:

- Kryerja e anketimeve të biodiversitetit për të vlerësuar pasurinë e specieve dhe cilësinë e habitatit.
- Monitorimi i ndryshimeve të biodiversitetit në një hark kohor të caktuar.
- Propozimi i masave për ruajtjen e biodiversitetit referuar rezultateve të anketimit;

Përshtatja dhe zbutja e efektit të ndryshimeve klimatike:

- Identifikimi i sektorëve vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike dhe propozimi masave për zbutjen e tyre;
- Promovimi i praktikave të qëndrueshme për të reduktuar emetimet e gazeve serrë.

Çështje mjedisore dhe promovimi i praktike të mira:

- Hartimi i planeve të menaxhimit të mbetjeve;
- Auditimi i banesave për të rritur eficiencën e energjisë;

Hartografimi:

- Përdorni Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) dhe hartografimi me mjete intelifhente (dron).
- Hartëzimi e veçorive mjedisore, përdorimi i tokës dhe ekosistemet;
- Analizimi i të dhënave hapësinore për të ofruar sugjerime të bazuara mbi informacion.

Kualifikimi dhe aftësitë e të interesuarve:

- Të jetë në vazhdim apo të ketë përfunduar studimet universitare në një nga fushat e listuara: menaxhim mjedisor, inxhinieri mjedisi, planifikim hapësinor dhe urban, dhe/ose fusha të ngjashme;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punoj mirë në grup;
- Aftësi analitike dhe organizative të mira;
- Njohuri të programeve ArcGIS/QGIS, Illustrator do të konsiderohen vlerë e shtuaretj;
- Njohuri të mira të gjuhës shqipe dhe angleze (të folur dhe të shkruar);
- I/e gatshëm/e për të zhvilluar vizita në terren brenda dhe jasht vendit.

Të interesuarit mund të na kontaktojnë në: info@uri.org.al dhe shohin faqen Web: <https://uri.org.al/sq/>